



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 30.3.2026, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit, Jeta Rafuna Hasani, LDK, Amir Simnica, LDK, Dhurata Jahaj Retkoceri, LDK, Leutrim Retkoceri, PDK, Fjolla Vukshinaj Reçica, PDK, Agron Canolli, PDK, Nora Kelmendi, LVV, Gëzim Sveçla, LVV, Kreshnik Smajlaj, AAK, Arbenita Murseli, Lidhja e Prishtinës.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Luftar Braha, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Kushtrim Mushica, drejtor i Drejtorisë së Sportit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi i Komitetit z. Fehmi Kupina me këtë

R E N D T Ë D I T Ë S:

- 1. Propozim-vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;**
- 2. Propozim-vendimi për emërimin e delegatëve për Kolegjiunin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK);**
- 3. Propozim-vendimi lidhur me Planin e veprimit për shërbime sociale në Kryeqytet 2026-2028;**
- 4. Plani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2026;**
- 5. Propozim-vendimi për subvencionimin e klubit të basketbollit të femrave "Prishtina" (KBF "Prishtina");**
- 6. Propozim-vendimi për subvencionimin e klubit të volejbollit "Prishtina";**
- 7. Propozim-vendimi për subvencionim e klubit të basketbollit "Sigal Prishtina";**

Faqe 1 nga 15

8. Propozim-vendimi për subvencionimin e "FC Prishtina 01 - Futsal";
9. Propozim-vendimi për subvencionimin e "KV "Prishtina 75";
10. Propozim- vendimi për subvencionimin e "3x3 "Prishtina";
11. Propozim-vendimi për subvencionimin e "KH "Prishtina";
12. Propozim-vendimi për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, 01. nr. 110 - 2782, më 2.12.2011, për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale;
13. Raporti financiar buxhetor i kryeqytetit, për periudhën 1 tetor - 31dhjetor 2025 (TM4);
14. Raporti financiar buxhetor i kryeqytetit, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2025;
15. Të ndryshme.

Pika e parë

Propozim-vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi, lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, tha se sipas Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, Statutit të Komunës së Prishtinës dhe udhëzimeve administrative për formimin dhe funksionimin e komiteteve të përhershme, propozoj që Kuvendi të formojë Komitetin për Komunitete me këtë përbërje, ku numri total duhet të jetë dy anëtarë nga komunitetit shumicë, propozimi i kandidatëve do të bëhet drejtpërdrejt në Kuvend gjatë seancës së caktuar për nesër. Propozimi i kandidatëve do të shqyrtohet dhe më pas do të miratohet me vendimin e Kuvendit.

A dëshiron dikush ta marrë fjalën?

Urdhëro, z. Sveçla!

Gëzim Sveçla lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se në vendimin që na e keni dërguar thuhet përfaqësuesi i shumicës edhe janë tre, prandaj shtroj pyetjen se a mund të na japë dikush sqarim se pse kështu edhe bazuar në çka, sepse për formimin e komiteteve të përhershme, ku bën pjesë Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete, ka një Udhëzim administrativ që është shumë i qartë. Prandaj, shtroj pyetjen se pse ka dalë ky anëtari i tretë i shumicës në këtë vendim që e kemi.

Osman Bllaca lidhur me diskutimin e z. Sveçla, theksoi se në bazë të Rregullores për themelimin e Komiteteve të përhershme të Komunës së Prishtinës, e miratuar në vitin 2014, ku janë tre anëtarë shqiptarë, e dy duhet të jenë anëtarë të Kuvendit kurse një tjetër i shumicës.

Ai në vazhdim tha se ne çdoherë kemi vepruar bashkërisht me grupe dhe kemi caktuar njërin prej anëtarëve, p.sh. në legjislaturën e kaluar kemi caktuar njërin prej punëtorëve nga Sektori i Kuvendit, që ka qenë Arton Brahim.

Gëzim Sveçla lidhur me sqarimin e z. Bllaca, shtroi pyetje se pse nuk i kanë edhe komunat tjera as nuk e parasheh Udhëzimi administrativ.

Osman Bllaca u shpreh se ne me Rregulloren tonë e kemi paraparë dhe kemi vepruar ashtu çdo herë.

Pra, jemi duke folur për shumicë shqiptare e jo për atë parlamentare, edhe vendimi është i bazuar në Rregulloren e vitit 2014, pra kështu kemi vepruar çdo herë dhe këtë të tretin mundemi me e zgjedhur kë të doni bashkërisht.

Gëzim Sveçla bëri të ditur se lidhur me këtë nuk ka asnjë arsye as ligjore, as praktike që ky i treti me qenë dikush që nuk është i asamblesë, për shkak se ky Komitet ka shumicën prej komuniteteve, në këtë rast ndërkohë tre të cilët janë përfaqësues të shumicës nuk ka përfaqësim më të mirë se të jenë prej Kuvendit.

Osman Bllaca tha se tek Rregullorja, neni gjashtë thotë se tre përfaqësues të komunitetit shqiptar së paku njëri prej tyre duhet të mos jetë anëtarë i Kuvendit të Komunës, kurse dy të tjerët duhet të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Pas ca diskutimesh lidhur me zgjedhjen e anëtarëve nga shumica shqiptarë, po i zgjedhim tre anëtarë të Kuvendit.

Gëzim Sveçla tha se ne edhe në mandatin e kaluar e kemi formuar këtë Komitet, është e njëjta formulë, do të thotë duhet me pasur përfaqësimin e Kuvendit, Nëse ju kujtohet, u patëm mbivotuar si LVV, ku PDK-ja dhe LDK-ja patën propozuar nga një përfaqësues të vetin, por ai vendim është kthyer nga MAPL-ja e pastaj e kemi përsëritur. Për të mos ndodhur prapë e njëjta, propozoj që të dakordohemi dhe të shkojmë në seancë të përgatitur.

Pika e dytë

Propozim-vendimi për emërimin e delegatëve për Kolegjin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK).

Kjo pikë e rendit të ditës mbetet të diskutohet në seancën e Kuvendit, e cila do të mbahet nesër.

Pika e tretë

Propozim- vendimi lidhur me Planin e veprimit për shërbime sociale në Kryeqytet 2026-2028.

Adelina Sahiti lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, theksoi se është kënaqësi me e diskutuar sot para jush dhe me treguar se sa është e rëndësishme që si kryeqytet ta kemi një Plan të veprimit për shërbime sociale për vitet 2026- 2028. Ne edhe në mandatin e kaluar e kemi pasur një plan të tillë. Ky është një plan trevjeçar, pra plan i cili është i mbështetur kryekëput në nevojat që janë për qytetarët dhe kategoritë e cenueshme në kryeqytet.

Ajo në vazhdim tha se ne këtë plan e kemi përgatitur gjatë vitit të kaluar, ku kanë qenë disa punëtori, të cilat janë mbajtur në partneritet me shoqatat e fëmijëve dhe me Qendrën për Punë

Sociale, por sigurisht pjesë integrale e Planit të veprimit kanë qenë të gjitha organizatat të cilat operojnë në kryeqytet e që e mbulojnë fushën sociale, duke e ditur rëndësinë që secila e ka për kategoritë që i mbulojnë.

Kemi qenë shumë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm sikurse edhe herën e kaluar, që në këtë plan të veprimit përveç që të përfshijmë të gjitha grupet e cënueshme, të ofrojmë mbështetje konkrete në bazë të buxhetit që e posedojmë edhe si drejtori, në mënyrë që mos të kemi një plan i cili pastaj nuk do të mund të jetësohet dhe nuk do të mund të realizohet në mungesë të buxhetit, sepse një plan pa buxhet sigurisht që nuk mund të realizohet.

Prandaj shfrytëzoj rastin të falënderoj para jush të gjithë kolegët që kanë punuar që sot ta kemi një dokument të tillë, ku dhe kemi bashkëngjitur edhe aneksin, i keni dy anekse para vetes, të cilat tregojnë edhe aspektin ligjor se ku jemi mbështetur, sepse ky plan pastaj është derivate i strategjisë së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila ishte ndarë në disa ministri deri tashmë sa e kemi Ministrinë e Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare. Pra d.m.th. se është derivat i gjithë legjislacionit që e kemi në dispozicion. E kemi të rëndësishme dhe i kemi përmendur katër fushat specifike të cilat do t'i mbulojë Plani i veprimit.

E para, është shërbime të integruara për grupet e cënueshme; e dyta, mbështetje për personat me aftësi të kufizuara; e treta, zhvillim i kapaciteteve dhe burimeve njerëzore, telekëshillim, digjitalizim i bazës së të dhënave; dhe e katërta, është për strehim, rehabilitim, riintegrim dhe risocializim për grupet në nevojë për mbrojtje sociale.

Fokus të veçantë kanë edhe të moshuarit në këtë pjesë. Ne kemi pasur mbështetje edhe nga GIZ-i gjerman, ku kemi bërë edhe një hulumtim për nevojat e grupeve të të moshuarve në kryeqytet, dhe pastaj sigurisht është derivat në matricën të cilën e keni para jush për këto tri vite që na presin, me shpresën dhe besimin e madh që ta arrijmë t'i mbulojmë të gjitha nevojat që kanë qytetarët e Prishtinës, veçanërisht grupet e cënueshme.

Pika e katërt

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2026.

Kryesuesi tha se pas takimit lidhur me plotësimin e Planit të Kuvendit sipas kërkesave të Komisionit, ju njoftoj se kërkesat e komisionit janë implementuar dhe plani i përditësuar është dërguar te ju për shqyrtim përmes e-mailit.

Ju kisha lutur që nëse keni ndryshime apo sugjerime, mund t'i bëni të ditura gjatë seancës së Kuvendit ose edhe tani, duke i komunikuar drejtpërdrejt, në mënyrë që t'i implementojmë në Plan.

Nëse nuk ka sugjerime të reja, plani vazhdon sipas versionit të dërguar për miratim në Kuvend. Nuk pati diskutime lidhur me këtë.

Pika e pestë

Propozim- vendimi për subvencionimin e klubit të basketbollit të bfemrave "Prishtina" (KBF "Prishtina").

Kryesuesi - për këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia dha drejtorit të drejtorisë përkatëse z. Mushica.

Në dakordim me drejtorin z. Mushica, u propozua që pika e pestë, e gjashtë, e shtatë, e tetë, e nëntë, e dhjetë dhe e njëmbëdhjetë të shkojnë në pako për votim.

Kushtrim Mushica lidhur me pikat e lartcekura tha se, si në çdo vit, ne i mbështesim klubet e mëdha të qytetit nëpërmjet Kuvendit me propozimet që i kemi bërë.

Në të kaluarën ka pasur vërejtje, për shkak të procedurave që nuk i kemi bërë si duhet për shkak të një komisioni, ku në vitin e kaluar e kemi hapur thirrjen e subvencioneve të rregullta. Komisioni ka qenë i përbërë prej pesë anëtarëve dhe ka nxjerrë shtatë rekomandime për shtatë klube dhe në këtë mënyrë ne i kemi këto rekomandime. Për shkak të situatës në vitin 2025 këto nuk kanë mundur të shkojnë tutje në Kuvend. Prandaj, po e shfrytëzojmë rastin këtë vit t'i përfshijmë në këtë seancë dhe normal klubeve të ju kryejmë obligimet të cilat i ka nxjerrë komisioni. Andaj ju kisha lutur që t'i shqyrtoni.

Jeta Rafuna Hasani u shpreh se me marrjen e materialit e kam parë vlerësimin nga komisioni që është bërë për përzgjedhjen e këtyre klubeve për subvencionim, natyrisht gjithmonë jam për përkrahjen e sportistëve dhe klubeve. Mirëpo desha me e ditur qysh kanë qenë kriteret që po përfitojnë zakonisht çdo vit të njëjtat klube. Gjithashtu si grup kemi dy kërkesa apo dy ankesa të cilat janë refuzuar, është klubi i hendbollit "Prishtina" femrat dhe klubi i futbollit "Mabetex Prishtina".

Andaj kisha kërkuar sqarim se pse janë refuzuar dhe pse janë kualifikuar këto klubet të cilat sipas meje çdo vit përfitojnë të njëjtit.

Kushtrim Mushica lidhur me diskutimin e znj. Rafuna Hasani, tha se zakonisht edhe në të kaluarën, tash kjo daton prej shtatë-tetë viteve më herët, kur kanë qenë më pak klube dhe gradualisht duke u rritur buxheti janë shtuar edhe klubet tjera, është përfshirë edhe futballi, sepse nuk ka qenë në të kaluarën, është përfshirë edhe "3x3 Trier Challenger" edhe tash me këtë buxhet të njëjtë nuk ka pasur mundësi me u shtuar edhe ndonjë klub tjetër.

Pra prej këtij viti, siç e dini, është rritur buxheti i subvencioneve, besoj se edhe komisioni do ta ketë parasysh t'i përfshijë edhe këto klube që ju i përmendët, sepse mendoj se edhe ato klube janë duke përfaqësuar qytetin tonë në mënyrë më të mirë dhe besoj se kjo do të vijë në shprehje në vitin që jemi tani.

Kreshnik Smajlaj shtroi pyetje nëse kishte mundur të propozojë që "Futball Prishtinën" dhe "Mabetex Prishtinën" me e futur në rend të ditës, meqenëse janë vetëm tri ekipe edhe kjo është superligë, një është përkrahur, është edhe një në listë vetëm kjo nuk është ku besoj se edhe ajo ka nevojë për ndihmë.

Pra, nëse e kam edhe përkrahjen tuaj do ta kishim futur edhe atë në rend të ditës.

Kushtrim Mushica bëri të ditur se këto klubet që u përmenden janë mbështetur në thirrjen për subvencione të rregullta e jo nëpërmes Kuvendit, d.m.th është ndarë buxhet për to, është shpallur lista edhe ata janë përfitues, ku dhe i kemi nisur procedurat, po presim me u nënshkruar kontratat edhe me i ekzekutuar.

Nora Kelmendi kërkoi që një përfaqësues i Zyrës ligjore me qenë prezent në KPF. Tani po na nevojitet përfaqësuesi i Zyrës ligjore për të na shpjeguar kornizën ligjore për ndarjen e këtyre subvencioneve.

Ju e dini që subvencionet ndahen me thirrje publike, thirrja publike është bërë me 15 maj 2025, ndërsa tash, në kundërshtim me ligjin, i sillni disa subvencione në KPF, pastaj në Kuvend për t'i miratuar Kuvendi.

Ajo në vazhdim tha se kjo nuk ka ndodhur asnjëherë as në kohërat përpara, as në kohën e Përparim Ramës, kur ka filluar me punuar i ka sjellë subvencionet në Kuvend me vendim të kryetarit, ndërsa tash i sjell subvencionet në Kuvend me shpallje publike.

Pra ka qenë thirrja publike, dokumentacioni prej klubeve sportive ka ardhur në komision Komisioni i ka shqyrtuar, i kam kontrolluar të gjitha, edhe tash i sillni në Kuvend subvencionet për t'i miratuar Kuvendi. Në cilin ligj jeni thirrur apo në cilin rregullore? Se nuk ekziston asnjë ligj, asnjë rregullore, që subvencionet me i miratuar asamblistët, Kuvendi. Unë për atë po e kërkoj që edhe Zyra ligjore me interpretuar këtë çështje, se me të vërtetë nuk na ka ndodhur asnjëherë.

Kushtrim Mushica theksoi se këtë praktikë e kemi gjetur, e dini që daton edhe prej periudhës së Vetëvendosjes, nuk po e them me ndonjë qëllim mirëpo e kam përkrahur gjithmonë sepse po shkojnë tek klubet sportive të qytetit tonë. Mirëpo është dashur tani me e gjetur një zgjidhje të re, sepse kemi pasur vërejtje edhe prej auditorit, e kam marrë një praktikë prej një Komunës tjetër, rastisa me dëgjuar edhe më herët këtu kështu që është një praktikë që nuk kanë marr vërejtje prej auditorëve dhe për mos me e ndalur këtë proces, e kam zgjedhur këtë proces apo e kam gjetur këtë zgjidhje, si dhe jam konsultuar me Zyrën ligjore dhe me auditorët. Më është thënë se në këtë mënyrë nuk do të hasim në vërejtje.

Nora Kelmendi tha se kur kemi qenë LVV-ja këtu, subvencionet nuk janë ndarë as nuk është e gjetur e auditorit sa i përket LVV-së kur ka qenë në pushtet në Komunën e Prishtinës. Nuk e di në kohën e Shpendit, se pastaj ka shkuar PSD-ja etj.

Ajo në vazhdim tha se nuk e di cilin auditor e ke pyetur, apo cilën Zyrë ligjore, nëse keni opinion ligjor të Zyrës ligjore, kishte me qenë mirë me e pasur ne atë opinion ligjor të gjithë asamblistët, se e gjetura e auditorit është se i sillni me vendim të kryetarit subvencionet, tash nuk i keni sjellë me vendim të kryetarit, tash i keni sjellë subvencione me rekomandime të Komisionit, për atë po kërkoj interpretim nga Zyra ligjore.

Kushtrim Mushica tha se duke pasur vërejtje pse po vjen me vendim të kryetarit edhe nuk ka një komision për përzgjedhjen e tyre, ne e kemi ndjekur këtë rrugë, d.m.th. një komision e ka vlerësuar dhe e ka rekomanduar që me shkuar nëpërmes Kuvendit.

Gëzim Sveçla tha se është evidente që ekziston një disponim i të gjithëve këtu që janë që me i ndihmuar klubeve sportive, por fatkeqësisht, Kushtrim, nuk e kemi gjetur mënyrën, nuk është se nuk ka pasur mënyrë, por kjo nuk është mënyra e duhur. Është bërë një komision ashtu siç parashihet me ligj, i cili i shqyrton aplikimet për subvencione, që është detyrë e Komisionit, a i plotëson ky klub apo çfarëdo cilësie që është OJQ, a i plotëson kriteret e kërkuara nga Komuna, nëse i plotëson i aprovohet një shumë e nënshkruar me kontratën edhe i gëzon ato mjete, por nuk është kompetencë e Komisionit me rekomanduar.

Pra do të ishte mirë që lidhur me këtë gjetjen me na treguar se cila Komunë i ka bërë; e dyta, na mungon opinioni ligjor prej Zyrës ligjore, sepse në formën qysh na kanë ardhur këto nuk kanë bazë ligjore dhe gjithçka pa bazë ligjore ne e dimë që përfundon me vendim të kthyer, siç janë kthyer të tjerat prej MAPL-së.

Ai në vazhdim u shpreh se çka është diçka tjetër mjaft shqetësuese, ne e dimë se përpos që është e gjetur e auditorit, për këtë rast ka edhe hetime të organeve kompetente, për shkak se llogaritet keqpërdorim i buxhetit të Komunës kur mjetet ndahen pa bazë ligjore.

Mes tjerash, ai tha se klubi i basketbollit i femrave "Prishtina" është përfitues i 41 mijë e 500 eurove prej Ligjit për sponsorizim, po flasim për vitin e kaluar, klubi i volejbollit "Prishtina" 13 mijë euro, "Futboll Prishtina" 109 mijë euro i kanë siguruar, apo shpenzuar prej Ligjit për sponsorizim vitin e kaluar, "Prishtina 3x3" për të njëjtin projekt i ka marrë 86000 euro prej MKRS-së, kurse "Sigal Prishtina" i ka inkasuar prej Ligjit për sponsorizim 1 milion e 200 mijë euro vitin e kaluar. Edhe tash një klub i cili i ka marrë për një vit 1 milion e 200 mijë euro edhe me ardhur me na kërkuar edhe 50 mijë euro prej Kuvendit të Komunës, kur ka klube tjera që nuk kanë një drekë me ua dhënë lojtarëve para lojës, e ne me i votuar edhe 50 mijë euro përpos që nuk është në rregull ligjorisht edhe moralisht, është që nuk mundemi me e kaluar këtë pikë.

Kushtrim Mushica duke u ndërlidhur në diskutim, tha se jam i hapur me marrë propozime. E din shumë mirë se edhe për këtë propozim të kam njoftuar. Jo vetëm me juve, por me secilin mundohem me e gjetur një rrugë ligjore, të drejtë, në mënyrë që këto mjete me shkuar tek klubet sportive të qytetit tonë.

Ai në vazhdim tha se është e vërtetë se klubet tjera ndoshta vuajnë financiarisht, por ndoshta duhet me ua lënë fajin edhe vet klubeve, sepse kur arrin një klub tjetër me i përfituar 100 mijë euro e një klub tjetër mos me përfituar prej Ligjit të sponsorizimit mos me bërë as një drekë me ua shtruar lojtarëve, vërtetë është për keqardhje.

Por këto janë edhe çështje të brendshme të klubeve që po dështojnë në menaxhim.

Kjo mënyrë pra është mënyra të cilën e kemi siguruar, kurse rekomandimet që vijnë prej komisionit janë vetëm rekomandime, ku besoj se kanë të drejtë me rekomanduar dhe ata nuk kanë marrë vendim të prerë, por vetëm një rekomandim e kanë dhënë dhe mbetet tek ju apo tek Kuvendi që të vendosni.

Nora Kelmendi shtroi pyetje, duke thënë se pasi i keni rekomandimet, e keni bërë shpalljen publike, pse nuk po i kryeni këto subvencionet vetëm që kanë dalë në vitin 2026, nuk po keni të drejtë apo për shkak të buxhetit.

Osman Bllaca tha se sa për sqarim, ne e kemi ndryshuar Rregulloren vitin e kaluar për ndarjen e subvencioneve edhe për këto kërkesat e veçanta çka janë, e parasheh neni shtatë, ku themelohet Komisioni, bëhet thirrja, sepse e gjetura e auditorit ka qenë për shkak të konkurshmërisë që nuk është zbatuar Udhëzimi administrativ, që është e nivelit qendror, ku është bërë shkelja prej anës tonë lidhur me ndarjen e subvencioneve.

Pika e dymbëdhjetë

12. Propozim- vendimi për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, 01.nr.110 - 2782, më 2.12.2011, për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale

Luftar Braha - tha se kjo është një prej Rregulloreve shumë e vjetër dhe nuk i përcjell dinamikat e zhvillimit të kryeqytetit në vitet e fundit ose komplet dekadën. Kemi menduar se ka nevojë për me e azhuruar Rregulloren për me marr parasysh një rend dhe barazi po ashtu edhe transparencë në bizneset që bëhen duke përfshirë aplikimin e plotë të udhëzuesit të Asociacionit të komunave të Kosovës në hartimin e Rregulloreve komunale për tarifa ,taksa, dhe gjoba komunale. Po ashtu duke përfshirë edhe bizneset të cilat kanë ndikim mjedisor dhe kërkojnë shërbime shtesë komunale ose ngarkojnë jetën në qytet, nuk po dua me marr shembuj konkret por është një listë shumë më e gjerë se ajo që ekziston tash .

Po ashtu në hartimin e kësaj kemi përfshirë edhe favorizimet ose diskriminimin pozitiv sidomos për bizneset e grave që me qenë të përkrahura dhe në fund me i përfshirë të gjitha këto biznese me dhënë kontribut në shërbime komunale d.m.th me u shtuar buxheti komunal.

Gëzim Sveçla - tha se pajtohem se duhet të ndodh ky farë përditësimi i Rregullores por tash tek dokumentet e dorëzuara ne e kemi vetëm një vendim për lënie në diskutim të Rregullores por është edhe një Draft rregullore për taksat komunale për ushtrimin e veprimtarive afariste. Tani shtroi pyetjen se a po e ndryshojmë këtë Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale apo kjo është një Rregullore tjetër tash apo është gabim ky dokumentacion.

Luftar Braha - tha se ne po e ndryshojmë rregulloren duke i futur të gjitha vendimet që kanë qenë të ndërmjetme prej vitit 2011 deri sot si pjesë e Rregullores së re, faktikisht kjo bëhet plotësim ndryshim i të njëjtës Rregullore pa krijuar Rregullore të re.

Pra futen të gjitha vendimet dhe kategorizimet e bizneseve që paguajnë tarifa futen brenda kësaj Rregullore, për mos me shkuar me shtuar vetëm amandamentime të cilat janë bërë vështirë të lexueshme dhe të... për qytetarët.

Gëzim Sveçla - tha se po ia ndërrojmë edhe emrin Rregullores se edhe emrin ia kemi ndërruar kjo po thotë Rregullore për taksa komunale për ushtrimin e veprimtarive afariste.

Pika e rendit të ditës është Plotësim ndryshimi i Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoha komunale apo flasim për këtë Rregullore apo tjetër.

Luftar Braha - emrin nuk do ia ndërrojmë se është gabim teknik.

Osman Bllaca - duke iu drejtuar z. Braha tha se janë dy lloj versionesh ose me themeluar Rregullore të re ose me bërë plotësim ndryshim të Rregullores së vjetër.

Ne e kemi diskutuar me Luftarin me e bërë plotësim ndryshimin e Rregullores, por plotësim ndryshime i janë bërë kësaj Rregulloreje dhe kemi dashur të gjitha plotësim ndryshimet me i fuzionuar me i bërë një.

Gëzim Sveçla - tha se duhet me e ditur se cilat janë fushat ku mendoni se duhet me u bërë këto ndryshime tarifave, cilat tarifa duhet me u rritur, cilat duhet me u shtuar apo ndoshta ka ndonjë tarifë që duhet me u hequr apo me shtuar ndonjë tarifë të re diku.

Ai në vazhdim tha se po e hapim në diskutim publik por mos pritni se do të vijë se ne e dimë se si përfundojnë diskutimet publike.

Luftar Braha - duke u ndërlidhur në diskutim tha se në nenin tetë është lista e tarifave të bizneseve dhe veprimtarive që duhen me u tarifuar, në këto ka kryesisht rritje e nuk ka zbritje të tarifave.

Ai në vazhdim tha se shumica prej tyre janë marr prej karakteristikave që kanë ndikim në jetën urbane në qytet në përgjithësi. Nëse një autolarje ose një vullkanizer nuk ka qenë i tarifuar prej Komunës përpara sot mendojmë se duhet me shkuar me u tarifuar dhe mendojmë që duhet me vazhduar me u votuar kjo sepse ata krijojnë një ndotje në ambient.

Ndërsa sa i përket pjesës për dëgjim publik që thatë është formalitet pasi që nuk kam përvojë të më hershme me e ditur se sa është por kisha shpresuar me pasur dëgjim publik në të cilin diskutohet dhe jemi të hapur për me diskutuar edhe të mirat edhe gabimet që ne mundemi me i bërë gjatë hartimit të Rregullores.

Gëzim Sveçla - duke u ndërlidhur në diskutim tha se neni tetë më duket shqetësuese pak dhe duhet një analizë e mirëfilltë, prodhimi i rrymës elektrike 1000 euro taksë kjo është kosto vjetore ama është kosto për secilin qytetarë të Prishtinës.

Meqë jemi duke jetuar në epokën kur po vihen këto panelet solare nëpër shpija ata po prodhojnë rrymë si edhe një varg veprimesh tjera.

Luftar Braha - duke u ndërlidhur në diskutim tha se ne e kemi pasur para sysh shumë edhe zhvillimin ekonomik, edhe investimet e reja në Komunën e Prishtinës me i tërhek e jo me i larguar e me i frikësuar njerëzit për me ardhur me investuar.

Megjithatë nëse nuk tarifojmë nuk mundemi të ofrojmë shërbime cilësore që e bëjnë Prishtinën atraktive për me ardhur këto biznese, d.m.th ne duhet me krijuar të hyra mbi të cilat të hyra ne ofrojmë shërbime.

Fjolla Vukshinaj - tha se mendoj se tek neni 7 pika 3 duhet me ndryshuar kush përfiton me i vendos edhe personat me nevoja të veçanta me ndryshuar pak me menduar kujt po i japim përkrahje.

Ndërsa sa i përket nenit 8 po mungojnë do shifra te kodi automjete me ndërmjetësim është mirë me i vendosur këto shifra. Edhe një propozim tjetër është mirë me na treguar sa parashihet rritja p.sh. pra nëse e kemi energji dhe shërbime publike tash është 1000 euro p.sh është rritja 20 apo 30% .

Luftar Braha - lidhur me diskutimin e znj. Vukshinaj tha se është problem me e shkarkuar Rregulloren e vjetër dhe me gjet në Rregullore të vjetër është shumë problematike.

Në vazhdim tha se vit për vit ka vendime të ndryshme të cilat bëjnë plotësim ndryshim të Rregullores pa i cekur as nenet si duhet të Rregullores.

Pra vërtet është shumë vështirë me naviguar por do të mundohemi që gjatë muajit që është në diskutim publik me e bërë listën e krejt tarifave, me bërë krahasimin për secilën pikë.

Do a bëjmë sigurisht.

Ai mes tjerash tha se jemi të hapur për të gjitha propozimet që mund të vijnë, mund të jenë edhe veteranët e UÇK-s si dhe kategori të tjera të cilat do ti mirëpresim.

Pika e trembëdhjetë

Raporti financiar buxhetor i kryeqytetit, për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2025 (TM4)

Valbona Makolli theksoi se sa i përket këtij raporti po filloj me performancën e të hyrave për periudhën e katërt të vitit 2025. Tek të hyrat ka qenë një realizim prej 3 milionë e 52 mijë e 408.27 euro, ku krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar ka një rritje. Kjo rritje ka ardhur si pasojë apo si realizim i të hyrave të planifikuara nga Inspekcioni, Tatimi në pronë dhe Infrastruktura rrugore, si dhe të hyrave të tjera me përqindjen siç i keni të paraqitura në tabelën në vijim.

Ajo në vazhdim tha se sa i përket performancës së shpenzimeve, shpenzimi buxhetor për periudhën e fundit, d.m.th. tremujori i vitit 2025, ka qenë 79 milionë e 744 e 55.33 centë, e cila krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak ka pasur rritje. Kjo rritje ka qenë si pasojë e alokimit të mjeteve nga të hyrat vetanake në këtë muaj, d.m.th. muajt e fundit të vitit, si edhe rritja e një vlere të përcaktuar në pagat dhe mëditjet si pasojë e rritjes së koeficienteve të stafit civil në Komunë.

Sipas kategorive, shpenzimet në pagat dhe mëditjet në këtë periudhë ka shënuar rritje, d.m.th. kjo është jo për shkak të numrit të punëtorëve, por për shkak të rritjes së koeficienteve, nuk po shkoj në vlera të cekëta që me ju marr kohë. Po ashtu, edhe te shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve gjatë kësaj periudhe raportuese ka arritur vlerën 7 milionë e 184.027.77 centë, apo që korrespondon me 23.22% të buxhetit të përgjithshëm.

Shpenzimet e komunalive kanë shënuar rënie në krahasim me vitin 2024, për arsye se gjatë kësaj periudhe kur veç shpenzimet janë më të mëdha, sikurse të gjitha komunat tjera, kemi pasur një

vlerë shumë të madhe të tërhequr nga kjo kategori ... çështje përmbartimore, të cilat kanë shënuar këtë vlerë numerike më të vogël në krahasim me vitin e kaluar.

Po ashtu, edhe tek kategoria e subvencioneve dhe transfereve kemi vlerën prej 1 milionë e 462 e 937, ku gjatë kësaj periudhe ka arritur realizimi prej 26.44% e buxhetit për këtë kategori.

Kurse tek shpenzimet kapitale është ekzekutuar 58 milion e 505. 472.98 apo 80.94%, d.m.th. siç e cekta më lart, ky shpenzim ka arritur për shkak të shpenzimeve përmbartimore, por edhe faturave të cilat i kemi kryer në këtë periudhë, kur veç në fund të nëntorit dhe në fillim të dhjetorit është bërë edhe alokimi i mjeteve të bartura nga viti 2024 në vitin 2025.

Tabelave nuk po iu qasem me rend meqë e kemi materialin. Atëherë po iu lë kohën që për këtë raport, nëse keni diçka, edhe pse afati është i shkurtër teknikisht deri nesër, të përmirësojmë apo të shtojmë diçka.

Nuk kishte të interesuar për të marrë fjalën për diskutim lidhur me këtë pikë.

Pika e katërbëdhjetë

Raporti financiar buxhetor i kryeqytetit, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2025.

Valbona Makolli

Siç e dini, si pasojë e mos votimit të buxhetit të vitit 2024 deri kah mesi i muajit qershor, kemi shpresuar se po bëhet miratimi, po formohet qeveria dhe do të shkojmë me vitin 2025. Mirëpo, siç e dimë, kjo është e tepërt me u përsëritur. Ne kemi mbetur pa buxhetin e vitit 2025 dhe në fund të vitit janë alokuar të gjitha mjetet e vitit 2024, dhe kemi punuar me projektet e 2024, por projektet normal janë të vitit 2025, sepse çdo projekt fillon në muajin mars dhe kemi shpresuar se deri në fund të vitit ndoshta do të bëhet buxheti.

Kështu që unë e kam paraqitur raportin ashtu si është marrë nga Ministria e Financave, sistemi i pagesave qeveritare dhe ashtu edhe e kam prezantuar.

Gjatë kësaj periudhe, d.m.th. për vitin 2025, performanca e të hyrave vetanake, realizimi ka qenë 42 milionë e 863.307, apo 11.65% më shumë se të hyrat e planifikuara për vitin 2025.

Kjo performancë është nga të hyrat. Zakonisht kjo rritje është shënuar për shkak të të hyrave nga tatimi në pronë, nga legalizimi, taksat e infrastrukturës dhe të hyrave të tjera.

Sa i përket performancës së shpenzimeve, në total shpenzimet buxhetore kanë arritur vlerën prej 157 milionë 418.901, apo kthyer në përqindje është 99.38% gjatë vitit 2025, kurse krahasuar me vitin 2024 është 13.91%.

Siç e dini, këta që kanë qenë më herët janë bërë me pesë kategori, shpenzime me mallra dhe mëditje, komunal, subvencione dhe shpenzimet kapitale.

Sa i përket shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve, është vlera 46 milionë e 476, apo ekzekutimi ka qenë 99.96%. Kjo është një rritje në vlerën prej 2 milionë e 595.110, si grant qeveritar që është alokuar në secilën komunë, si edhe në Komunën tonë, si pasojë e rritjes së koeficientit në pagat, krahasuar me buxhetin, d.m.th. ky është dallimi në mes tyre, kur e shohim buxhetin që e kemi aprovuar ky gati 2 milionë e 600 mijë nuk ka ekzistuar.

Mirëpo ky është një ndryshim i cili ka pësuar në komplet qeverinë, d.m.th. si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal.

Tek shpenzimet e kategorisë mallra dhe shërbime, po ashtu ka pasur një rritje të lehtë prej 3.66% në krahasim me vitin 2024, ku vlera e mallrave dhe shërbimeve është 30 milionë 928.149.85 apo korrespondon me vlerë prej 99.95% total i kësaj kategorie.

Tek shpenzimet e komunalive është shënuar një rritje e lehtë prej 3.71% krahasuar me vitin 2024, dhe vlera totale e shpenzimeve ka arritur në 2 milionë e 999.997 euro.

Ndërsa tek shpenzimet e kategorisë së subvencioneve dhe transfereve është shënuar vlera prej 5 milionë e 493.387, i cili në vlerën e nominuar në përqindje është 99.27% në total të këtij buxheti për këtë kategori.

Po ashtu, edhe tek kategoria e fundit, shpenzimet kapitale, është arritur vlera prej 71 milionë e 520.639.11, që korrespondon me përqindje 98.95% e planit të periudhës për të cilën po raportoj. Çka vlen të theksohet për mos me hyr në tabelat të cilat vetëm se i keni dhe do t'i kemi në dispozicion nesër në detale, sigurisht për të mos ju humbur kohë, gjë që vlen të theksohet se në përgjithësi jo vetëm Komuna jonë, por edhe të gjitha komunat dhe ministrinë kemi pasur një rritje enorme të ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore. Unë po flas vetëm për Komunën tonë, në përgjithësi është diku mbi 270 milionë sipas raporteve të fundit të Ministrisë së Financave, kurse vetëm në Komunën tonë janë 45 milionë e 724.459, 51%, prej këtyre shpenzimeve janë të operatorëve ekonomikë të cilët p.sh. i kanë kryer obligimet, punët ose shërbimet diku kah marsi apo prilli dhe kur e ka parë se nuk jemi duke mundur me i ekzekutuar pagesat, kanë shkuar përmes përmbarimorëve dhe i kanë marrë, kurse pjesa tjetër janë shujtat, pagat jubilarë në arsim, shëndetësi dhe të tjerat, kështu që unë kam shpërndarë nëpër drejtori ashtu qysh janë marr në secilën kategori ekonomike dhe e kam paraqitur vlerën e caktuar.

Nëse dikujt i intereson se sa është numri total i këtyre, janë mbi 18 mijë raste në Komunën tonë që janë, kështu që është e pamundur me i iu siguruar materialet Zyra ligjore, ne i kemi ndarë kështu.

Nëse ka dikush ndonjë pyetje lidhur me këto sa të kemi mundësi dhe hapësirë për material mundemi me ju ndihmuar. Pra kjo ishte në pika kryesore, kurse poshtë e kemi paraqitur edhe buxhetin qysh ka qenë fillestar edhe buxheti i cili është dashur me krahasuar se ka qenë viti 2025, por ne kemi punuar me mjetet e vitit 2024.

Përndryshe, për bartje ju njoftoj se kemi vetëm 10 milionë 811713 euro nga këto mjete, një pjesë është kthim i mjeteve dhe një pjesë e vogël ka qenë grand qeveritar.

Nuk ju kisha marr më shumë kohë për t'u lëshuar në detale. Nëse keni diçka për të pyetur, unë jam këtu me ju përgjigjur, por edhe nesër ka ndonjë gabim teknik mundemi ta përmirësojmë.

Faleminderit për vëmendj

Leutrim Retkoceri mori fjalën, duke falënderuar drejtoreshën për sqarimet e dhëna lidhur me raportin.

Me të drejtë e përmende që është barrë për buxhetin e Komunës, por edhe financat lokale, rasti me 18 mijë lëndë në përmbarim.

Unë kam kërkuar edhe më herët një raport, ku dihet se te operatorët sa janë pranuar rastet për përmbarim dhe sa janë prapësuar, sepse kjo e qartëson goxha shumë rrjedhën e parasë në

buxhet që mos me pasur situata me ardhur përsëri ndonjë bllokim i buxhetit të Komunës nga ngarkesat e shumta të përmbarimit.

Po besoj se kjo është mirë nëse Zyra ligjore ua ka dërguar këtë raport edhe juve, Drejtorisë së Financave, sepse mundet me e ngarkuar buxhetin në kohë shumë afatshkurtër nëse janë 18 mijë numri qenka jashtëzakonisht i madh.

Kjo do të ishte pyetja ime.

Fjolla Vukshinaj, duke u ndërlidhur në diskutim, tha se vërtet është lajm i mirë nëse kemi pasur një rritje të inkasimit dhe të të hyrave vetanake për 30%. Po ashtu, e lexova edhe një raport tjetër të GAP-it se Komuna e Prishtinës po qëndron mirë sa i përket konkurrencës buxhetore, por këto komente që po i jap lidhen që me i përmirësuar ende më shumë se në vitin 2024, kishim pasur disa komente.

Unë e di që ju e merrni një "Team Playd" edhe të Ministrisë së Financave sa i përket raportimit, por mendoj që ky trendi apo këto pasojat e fundit të përmbarimit, duhet bërë disa ndryshime. Këtu mendoj që është rishikimi dhe dizajnimi i paraqitjes së shpenzimeve të projekteve kapitale. Pasi që e përmende që rreth 42 milion janë marrë nëpër procese gjyqësore dhe përmbarimore, atëherë tek paraqitja e shpenzimeve kapitale mendoj se duhet me qenë paraqitja e projekteve kapitale, emërtimi, buxheti i planifikuar, pagesa për realizimin e projektit, plus të shtohen tash pagesat për vendime gjyqësore dhe gjithsej buxheti i shpenzuar dhe progresi i raportuar sipas realizimit të thesarit, pastaj e shohim se cili është realizimi real i projektit.

Kjo na ndihmon edhe neve si Kuvend, por edhe juve si drejtori, po të shtohen pagesat për vendimet gjyqësore, e përmendët që te investimet kapitale ka pasur bajagi, pastaj shtohet gjithsej buxheti i shpenzuar, edhe kjo na jap pasqyrën progresi i raportuar nga thesari që e merr edhe nga realizimi real.

Po ashtu, diçka që është shumë e rëndësishme te raportet, është me i paraqitur evidencat dhe dëshmitë e projekteve të realizuara, kishte me qenë shumë mirë dhe kishte me bërë më atraktive interaktiv nëse vendosim ndonjë fotografi. Unë kam parë që komunat e tjera vendosin fotografitë në këto raporte, kështu që mundesh me i paraqitur 2-3 raste, prej të realizueshmeve të suksesshme. Edhe, e fundit, e kam parë që ke vendosur disa fusnota, p.sh. tek kjo pjesa përmbarimore, ku e ke bërë një sqarim shtesë, që ka qenë shumë e mirë dhe më ka pëlqyer shumë, por mendoj se duhet me futur më shumë fusnota për sqarime shtesë, se një pikë që e kam parë në disa pjesë të raportit, e kam parë termin "pajisje shtesë", e është mirë që edhe këtu me u sqaruar se cilat janë këto të tjerat.

Këto e kompletojnë edhe indeksin e transparencës buxhetore, po ashtu e bëjnë më të lexueshme dhe më të qartë edhe për qytetarët edhe për palët tjera të interesit.

Gëzim Sveçla u shpreh se, meqë është adresimi im i parë, po dëshiroj që këtij Komiteti me i uruar punë të mbarë dhe bashkëpunim të ndërsjellë.

Gjithmonë duke u munduar me i kuptuar rrethanat që kanë ngjarë gjatë vitit të kaluar dhe situatën në të cilën është përpiluar ky raport, unë vetëm dua ta marr mendimin tënd si eksperte e fushës dhe si drejtoreshë që je një kohë të gjatë në këtë pozitë.

A mendon se është raporti përkundër faktit se mundet të jetë i saktë në kuptimin e numrave dhe barazimeve që rrjedhin nga të hyrat dhe shpenzimet, është raporti më i pasaktë që i ofrohet ndonjëherë Kuvendit komunal të Prishtinës?

Kur po e them këtë, po nisem nga fakti se, p.sh. investimet kapitale vlerësohen 99% gati të realizuar, a e dimë saktësisht sa është vlera e investimeve kapitale? P.sh. nëse nisemi nga ato të cilat janë të prezantuara si investime kapitale 4 milionë e gjysmë për nënkalinimin në rrugën "Agim Ramadani", 2 milionë për sallën koncertale, d.m.th. projektet as që kanë filluar.

Ai në vazhdim tha se kur të hiqet një shumë e tillë e mjeteve që me gjasë është diku gjysma e gjithë vlerës ose e gjithë shumës që është parashikuar tek investimet kapitale, sa bie kjo përqindja e investimeve kapitale në praktikë, më konkretisht sa projekte të cilat aktualisht ose janë zhvilluar, ose zhvillohen në kryeqytet, janë financuar prej buxhetit të Prishtinës.

Kjo arrihet shumë lehtë nëse i largojmë mjetet të cilat janë tërhequr prej vendimeve gjyqësore ose prej përmbaruesve.

E pashë, p.sh tek pagesa e rrymës, 300 mijë euro kemi paguar rrymë, zakonisht paguajmë 1 milion e gjysmë, pse ka ndodhur kjo tash këtu është efekti domino që ne ose kemi me e paguar kësaj radhe, ose prapë kemi me shkuar tek përmbaruesit, e që prapë në raportin financiar për këtë vit ose në cilindo tremujor që tërhiqen ato mjete, kanë me na dhënë shifra të pasakta.

Pse ka ndodhur që kemi paguar vetëm 300 mijë euro rrymë?! Por shumë pyetje dhe përgjigje do të kërkojmë në seancë.

Kam një pyetje për fund, por të lutem mos e merr personale.

Tash i kontrollova vendimet e kryetarit prej fillimit të mandatit edhe nuk gjeta vendim për emërimin tënd në pozitën e drejtoreshës.

A jeni drejtoreshë e emëruar me vendim?

Valbona Makolli theksoi se sa i përket pyetjes së parë të Leutrimit, sa kam mundur me i përmbledhur, Zyra ligjore nuk e ka një evidencë të saktë, e ka evidencë nën evidencë. Ne prej thesarit kemi kërkuar më shumë detale, sidomos për operatorët ekonomikë, me arsyetim që mos me u bërë pagesa e dyfishtë, ata i kanë qar disa prej tyre por nuk janë 100%, për arsye se një operator ka mundur me i pasur dy apo tri projekte të tjera, kurse për pagat dhe ato jubilarë dhe të tjerat është lista tek Zyra ligjore. Tani, sapo të shkoj në zyre do ti shkruaj Zyrës ligjore, në mënyrë që t'ua dërgoj raportet.

Sa i përket tabelave duhet me shtuar edhe një rubrikë se kjo është sipas një trajnimi që e kemi mbajtur në vitin 2019, atëherë me USAID-n, kanë qenë krejt këto të dhënat sipas ligjit në krahasim me vitet paraprake, por atëherë nuk është paraparë se vendime gjyqësore ka pasur shumë më pak se sa tani. Tani mundemi me e bërë nuk është për këtë vit, p.sh. kur fillojmë prej vitit 2026, vetëm rubrika, pastaj me formulë e nxjerr buxhetin total sa është i alokuar.

Ndërsa sa i përket këtyre me fotografi qysh ka qenë kjo në mandatin paraprak është bërë me raportimin ose me raport të kryetarit, se ka qenë më shumë në WORD me më shumë të dhëna të paraqitura.

Ajo mes tjerash tha se unë mundem të ua dërgoj drejtorive sa shpenzime ka pasur si raport, mirëpo në këtë raport financiar nuk e parasheh ligji me vazhduar tutje, ne kemi shkuar sipas asaj. Mirëpo nuk është e thënë se nuk mund të ndryshohet por e kemi parasysh.

Procesmbajtësi/ja
Lendita Spahija

Kryesuesi i Komitetit
Fehmi Kappina



